

Statistikat e krimeve

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadate Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	6
5. Periudha e referencës	6
6. Mandati institucional	6
7. Konfidencialiteti	7
8. Politika e botimit.....	7
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	8
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	8
11. Manaxhimi i cilësisë	9
12. Rëndësia.....	9
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	10
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Kohëria dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	11
17. Rishikimi i të dhënave	11
18. Përpunimi statistikor	12
19. Komente.....	13
Aneks	13

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Analizave Socio-Demografike, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Blerina Subashi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës i Sektorit të Analizave Socio-Demografike
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	bsubashi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	26/10/2018
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	26/10/2018
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p><i>Veprat penale dhe autorë</i></p> <p>INSTAT mbledh, analizon dhe publikon të dhëna mbi veprat penale, autorë dhe persona të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale. Statistikat mbi veprat penale bëjnë fjalë për vepra specifike të regjistruara nga policia, klasifikimi i të cilave bëhet duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Veprat e regjistruara janë ngjarje të evidentuara, jo gjykime të cilat janë në kompetencë të organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin.</p> <p>Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Ato përfshijnë të dhëna mbi autorët për vepra penale specifike dhe për totalin e gjithë veprave të regjistruara sipas gjinisë, grupmoshës).</p>

	<p>Një rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet jo vetëm evidentimit të veprave penale, luftës në kapjen e autorëve, por edhe mbrojtjes së pozitës së personit të dëmtuar nga kryerja e veprës penale. Të dhënat mbi të dëmtuarit përfshijnë të dhëna mbi veprat specifike dhe të dëmtuarit sipas gjinisë.</p> <p><i>Statistikat mbi personat e pandehur dhe procedimet penale</i></p> <p>Statistikat mbi procedimet penale dhe personat e pandehur pasqyrojnë të dhëna nga Prokuroria e Përgjithshme. Të pandehurit paraqesin të dhëna për personat të cilëve ju është njoftuar akuza për veprën penale dhe janë të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës dhe veprave penale.</p> <p><i>Statistika mbi të dënuarit</i></p> <p>Statistikat mbi të dënuarit pasqyrojnë numrin e individëve ndaj të cilëve janë aplikuar sanksione penale të cilat konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar deri në momentin e kryerjes së veprës penale. Sanksione këto që konsistojnë në dënime me burg, gjobë ose dënime alternative. Dënimet alternative mund të jenë gjysmëliria, punë në interes publik, pezullimi dhe qëndrimi në shtëpi. Të dhënat statistikore mbi të dënuarit përfshijnë: numrin e të dënuarve sipas gjinisë dhe grupmoshës, të dënuarit sipas llojit të krimit të kryer, dhe numri i të dënuarve sipas gjinisë.</p> <p><i>Statistika mbi të burgosurit</i></p> <p>Statistikat mbi të burgosurit përfshijnë personat e mitur (nën 18 vjeç), të rritur (mbi 18 vjeç) sipas gjinisë të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë si edhe të paraburgosurit ndër vite. Numri i të burgosurve tregon gjendjen e të burgosurve në një vit të caktuar duke përfshirë hyrjet e reja dhe daljet që ndodhin për periudhën në fjalë, dhe llogaritet si një mesatare e numrit të burgosurve për çdo muaj.</p> <p><i>Treguesit e krimeve</i></p> <p>Këta tregues llogariten mbi të dhënat e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë dhe përlllogaritjet vjetore të popullsisë banuese nga INSTAT.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	Statistikat Juridike bazohen në klasifikimin e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf)
3.3. Mbulimi i sektorit	Të dhënat mbulojnë faza të ndryshme të sistemit të drejtësisë: raportimi në polici, prokuroria, gjykatat dhe burgjet.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<i>Vepra penale:</i> Sjelle, veprime apo mosveprime me të cilat çënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen

në krime dhe kundërvajtje penale

Kundërvajtje penale: Kundërvajtjet paraqesin vepra të tilla me të cilat çënohet apo dëmtohen të mirat juridike me vlerë më të vogël krahasuar me veprat penale, pra çënojnë rendin juridik por nuk prekin bazat e tij dhe nuk kanë pasoja të rënda shoqërore.

Vepra penale të raportuara: Vepra të raportuara në polici ose mbi të cilat policia ka njohuri mbi to në mënyra të tjera.

Krime kundër personit: Kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) të kundërligjshme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të cilat prekin ose vënë në rrezik jetën, shëndetin, liritë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal.

Krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike: Përfshihen vjedhje pasurie, mashtrime, krime në fushën e doganave, tatim-taksave, shkatërrimi i pronës dhe krime që çënojnë regjimin juridik të tokës etj.

Vrasje me dashje: Vepër i kundërligjshëm, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përshihen veprat penale si: Neni 76 vrasje me dashje, Neni 77 vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 vrasje me paramendim, Neni 78/a vrasje për gjakmarrje, Neni 79 vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c vrasje për shkak të mardhënieve familjare, Neni 81 vrasje e foshnjës.

Krime seksuale: Marrëdhëniet juridike të vendosura në sferën e sigurisë së lirisë seksuale dhe të zhvillimit normal të formimit seksual, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal. Përfshihen Nenet 100-108/a të Kodit Penal

Krime me dashje kundër shëndetit: përfshihen neni 87 tortura me pasoja të rënda, neni 88 Plagosje rëndë me dashje, neni 89 Plagosje e lehtë me dashje, neni 89/a Shitblerje transplantesh dhe neni 90 Dëmtime të tjera me dashje.

Mashtrim: Kuptohet marrja ose hedhja në dorë me anë të gënjeshtres ose të shpërdorimit të betimit të pasurisë apo të të drejtave pasurore të personit fizik, personit juridik ose të shtetit, me qëllim të përfitimit material për vete ose për të tjerët. Përfshihen Nenet 143-149/b të Kodit Penal.

Krime në fushën e drogës: Përfshijnë veprat si prodhimi, kultivimi, shitja e lëndëve narkotike dhe trafikimi i tyre. Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Falsifikim monedhash: përfshihet neni 183 i Kodit Penal

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor: përfshihet veprat penale

si:neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi

Dhuna në familje: Përfshihen ato akte si rrahja, apo vepër tjetër dhune, kanosje serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e intergritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij. Neni 130/a i Kodit penal.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejon që të ndodh një vepër penale pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

I dëmtuar: Personi të cilit çfarëdo e drejtë personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale.

I mitur: Është çdo person nën 18 vjeç.

I dënuar: Personi i cili me veprat apo sjelljet e tij ka cënuar apo ka dëmtuar të mirat juridike që mbrohen me ligj. Ndaj këtyre personave aplikohen sanksione penale të cilat konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar deri në momentin e kryerjes së veprës penale.

Çështje penale: të gjitha ato çështje të cilat përpunohen në bazë të ligjit penal kombëtar.

Çështje civile: të gjitha ato çështje të cilat përpunohen në bazë të ligjit civil kombëtar.

Çështje të përfunduara: Numri i procedimeve të përfunduara/asgjësuar me vendim të gjykatës.

Çështje në dorë, në pritje: të gjitha ato çështje, procedime të cilat nuk janë finalizuar deri me 31 Dhjetor.

Numri i të burgosurve: Numri gjithsej i të burgosurve tregon numrin e personave të mbajtur në ambjentet e burgjeve, institucione të tjera, institucionet e burgosjes së të miturve, spitalet psikiatrike ose spitale të tjera. Përfshijnë si të dënuarit me burg dhe të paraburgosurit.

I dënuar me burg çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedural.

I paraburgosur: Përfshihen personat, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

Koeficienti i kriminalitetit: Numri i veprave penale të evidentuara për 10 mijë banorë në një vit të dhënë.

Norma e të burgosurve shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në burgje në privim lirie ndaj popullsisë residente prej 10 mijë banorë, në një vit të dhënë.

	<p><i>Të paraburgosur në privim lirie</i> shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në paraburgim që ende nuk janë dënuar, si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të personave të mbajtur në burgje në një vit të dhënë.</p> <p><i>Koeficienti i personelit te policisë</i> shpreh numrin total të oficerëve të policisë shprehur për 10 mijë banorë në një vit të caktuar</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e të dhënave është vepra penale, autorë, të pandehur, të dënuar dhe të burgosur.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet: veprat penale të regjistruara nga policia, numri i personave të dyshuar në kryerjen e një vepre, numri i personave të dëmtuar nga vepra penale, numri i personave të pandehur, të dënuar, të paraburgosur dhe të burgosur. Gjithashtu numri i personelit që punojnë në role specifike në sistemin e drejtësisë, numri i çështjeve të trajtuara nga gjykatat.
3.7. Zona e referencës	Të dhëna e agreguara janë në nivel qarku dhe vendi.
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2010 dhe në vazhdim për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Veprat penale ◆ Autorë ◆ Persona të dënuar ◆ Të burgosur
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet
4. Njësia matëse	<p>Në statistikat juridike përdoren njësi të ndryshme matëse.</p> <p>Njësia bazë statistikore në statistikat e krimeve është vepra penale dhe çështjet.</p> <p>Njësia matëse për viktimat e veprave penale, autorë, të pandehur, të dënuar, të paraburgosur dhe të burgosur, personeli në sistemin e drejtësisë është individ.</p>
5. Periudha e referencës	Ky raport i referohet vitit 2017.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Në nivel kombëtar, Statistikat e krimeve janë bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Ligj nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare". http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikatzyrtare.pdf ◆ Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021 http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/programi-kombetar-i-statistikavezyrtare.aspx ◆ Memorandum me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë ◆ Memorandum me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

6.2. Shkëmbimi i të dhënave	INSTAT transmeton të dhëna mbi krimet dhe drejtësinë penale në Eurostat në pyetësor, si pyetësori UN-CTS (të dhëna mbi krimet dhe drejtësinë penale) dhe pyetësori mbi hyrjet e paligjshme të kufirit.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Të dhënat publikohen në nivel të agreguar. Të dhënat nuk publikohen asnjëherë në nivel individual.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	INSTAT publikon çdo vit një kalendar për botimin e tij për vitin aktual. Kalendar i është i aksesueshëm publikisht në faqen e internetit të INSTAT-it. Njoftimet dhe vonesat janë të parashpallura në kalendarin e botimit. Në rastin e vonesave specifikohet data e ardhshme e publikimit, si dhe shpjegimi në lidhje me arsyet e vonesave.
8.2. Akses i kalendarit e publikimeve	Kalendar i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it në linkun e mëposhtëm http://www.instat.gov.al/al/publikime/kalendar/
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Website - online release • Kërkesat e shkruara

	<ul style="list-style-type: none"> • Publikimet e Krimeve dhe Drejtësisë Penale • Kërkesa për të dhëna në linkun: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrkes%C3%AB-t%C3%AB-dh%C3%ABnash/
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Shpërndarja e të dhënave të krimeve dhe drejtësisë penale bëhet në baza vjetore dhe tremujore përmes botimeve të përmendura më lart.
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Statistikat tremujore gjenden në linkun: http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografikë-dhe-socialë/krimet-dhe-drejtësia-penale/#tab3
10.2. Publikime	<p>Publikime për Statistikat e Krimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tremujore: Statistikat e krimeve <ul style="list-style-type: none"> ○ Publikime të përgjithshme, modul me statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale • Vjetore: <ul style="list-style-type: none"> ○ Burra dhe Gra, ○ Shqipëria në shifra, ○ Vjetari statistikor ○ Vjetari statistikor rajonal • Botim i dedikuar: <ul style="list-style-type: none"> ○ Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale
10.3. Baza e të dhënave on-line	Databaza Statistikore: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Nuk aplikohet
10.5. Të tjera	INSTAT transmeton të dhëna për Eurostat në lidhje me krimet dhe statistikën juridike nëpërmjet një koleksioni të përbashkët të të dhënave të Eurostat-UNODC, çdo vit në shtator. Pyetësi i UNODC përfshin 8 fletë për t'u plotësuar dhe plotësohet nga pyetësi i Eurostat-it. Pyetësi i Eurostat përbëhet nga 1 fletë që përmban pyetje të kërkuara nga Komisioni Evropian për fushat e tij specifike të politikave. Pyetësi përmban të dhëna për veprat penale të regjistruara, kryerësit, viktimat e vrasjeve, të dhënat mbi ndjekjen penale, të burgosurit, personat e dënur dhe të pafajshëm.
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Të dhënat janë siguruar nga burime administrative në vend si Drejtoria e Policisë së Shtetit, Prokuroria, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Burgjeve.</p> <p>Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe metodologjisë për statistikën juridike i vihet në dispozicion përdoruesve në fund të publikimeve si dhe në temën Krimet dhe Drejtësia Penale në linkun: http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/krimet-dhe-drejt%C3%ABsia-penale/#tab4</p> <p>Informacione të tjera shtesë ju ofrohen përdoruesve të brendshëm nëse kërkohen.</p>

10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Analizave Socio-Demografike dokumenton të gjithë proceset dhe procedurat e punës për përdorim të brendshëm.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimi i të dhënave për statistikën juridike është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e statistikave juridike klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Institucionet e Administratës Publike; ○ Universitetet; ○ Bizneset, ○ Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; ○ Organizata kombëtare jofitimprurëse; ○ Disa tregues kryesorë dërgohen në Eurostat, UNODC. • Përdoruesit e brendshëm janë brenda INSTAT të cilët përdorin Statistikat Juridike si input për punën e tyre. <p>Qëllimi kryesor i prodhimit të statistikave juridike është sigurimi i një informacioni më të plotë për shkak të rëndësisë sociale që mbartin këto statistika si dhe për shqetësimet e publikut lidhur me to.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	Page Views (Klikime) në lidhje me Statistikat Krimeve për vitin 2017 janë rreth 1,183 klikime. INSTAT gjatë vitit 2017 ka realizuar për herë të parë Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Pyetjes: "Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të statistikave për fushën e Statistikat e Krimeve?" në shkallën nga 1 tek 5 (1=shumë e dobët, 2=e dobët, 3=e përshtatshme, 4=e mirë, 5=shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënave me një mesatare prej 3, 51 (70.2%). Më poshtë

	gjeni linkun e rezultateve të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. http://www.instat.gov.al/media/2974/anketa-mbi-kenaqesine-eperdoruesve.pdf
12.3. Plotshmëria	INSTAT transmeton në Eurostat pyetësor për statistikat juridike. Pyetësori është bashkim pyetësorësh me 7 fletë nga UNODC dhe 1 fletë nga Eurostat. Në total janë 161 indikatorë kryesor, nga të cilët Instat plotëson aktualisht 80 indikatorë. Pyetësori përfshin dhe tregues jo kryesor (rotating) të cilët ndryshojnë sipas periudhës referuese.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Nuk aplikohet
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet
13.3. Gabim jo i kampionimit	Para se të dhënat të publikohen, Instat kontrollon nëse ka ndryshime në trend ose llogaritje të gabuara, të dhënat rishikohen. Duke qenë se të dhënat prodhohen manualisht, ka mundësi gabimesh. Në të dhënat tremujore nga Drejtoria e Policisë, ndryshimet në numrin e veprave penale dhe autorëve, mund të jenë të shpeshta: neni i një veprave penale mund të ndryshojë ose mund të mos përbëjë një vepër penale. Në këtë rast, INSTAT rishikon të dhënat që reflektohen në publikimin e rradhës.
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	
14.1. Afatet kohore	Viti referencë i referohet vitit kalendarik dhe të dhënat janë finale. Publikimi bëhet në mënyrë rigoroze në përputhje me datat e publikuara për të gjitha botimet në faqen e web-it të INSTAT.
14.2. Përpikmëria	Publikimi i të dhënave kryhet në përputhje me kalendarin e statistikave të krimeve që INSTAT përpilon dhe publikon për çdo vit, në linkun e mëposhtëm: http://www.instat.gov.al/al/publikime/kalendari/ . Publikimi i statistikave të krimeve ka qenë i përpiktë në kohë në 93% të publikimeve të kryera gjatë viteve. Për arsye të vonësës në burimet administrative publikimi i Statistikave të Krimeve të tremujorit të dytë të 2017 është publikuar 5 ditë pune me vonësë.
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Statistikat juridike në disa botime paraqiten në nivel prefekturë ku përfshihen: Berat; Dibër; Durrës; Elbasan; Fier; Gjikastër; Korçë; Kukës; Lezhë; Shkodër; Tiranë; Vlorë. Këto statistika janë relativisht të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave. Në të kundërt, dihet se statistikat e krimit në nivel ndërkombëtar kanë krahasueshmëri të ulët për shkak të rregullave të ndryshme të numërimit, legjislacioneve dhe rregullat e

	regjistrimit e kështu me radhë. Puna për të përmirësuar krahasueshmërinë është në vazhdim, për shembull nëpërmjet Eurostat dhe UNODC, të cilët kanë implementuar së fundi edhe klasifikimin ndërkombëtar për qëllime statistikore (ICCS).
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat e krimeve datojnë që nga viti 1993. Procedurat statistikore për regjistrimin e veprave kanë ndryshuar në disa raste, për shembull nëpërmjet mbledhjes së re ose metodave të reja të numërimit. Ndërkohë ngjarjet individuale mund të ndikojnë përkohësisht në statistikat për disa vite, këto ndryshime janë të rëndësishme për të kuptuar veprat e raportuara me kalimin e kohës. Për shembull, në vitin 2014, Policia zbatoi një sistem të ri për menaxhimin e çështjeve. Nga ky vit, të dhënat janë më të sakta dhe kemi një numër më të madh të veprave të regjistruara.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Klasifikimi i veprave penale në krime dhe kundërvajtje penale bëhet bazuar në Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Këto vepra të regjistruara bëjnë fjalë për ngjarje të ndodhura, të regjistruara nga policia, jo për gjykime të cilat janë në kompetencë të organeve të drejtësisë për të dhënë vendimin. Evidenca statistikore siguron të dhëna mbi veprat, ngjarjet e kryera në Shqipëri në nivel shtetëror; për çdo vepër penale evidenca përmban të dhëna për veprat penale (vepra të evidentuara, të zbuluara dhe rastet e zbuluara nga rastet e vjetra), të dhënat për personat e dëmtuar për çdo vepër të kryer dhe autorët e tyre, (personat e dyshuar) të ndara sipas masave të sigurimit.
15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave kontrollohet me rregullat e validimit të shumës, si shuma e nëntotalit, ndryshimet e mëdha ndër vite, ndryshime të mëdha, siç përmendet në raport. INSTAT mbledh të dhëna për Dhunën në Familje. Ofruesit kryesorë të të dhënave janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Gjykatat. Nga Policia marrim të dhëna për rastet e raportuara të dhunës në familje, nga gjykatat numrin e personave që kërkojnë mbrojtje (urdhër mbrojtje). Të dhënat për gjininë dhe grupmoshat janë për autorët dhe të dëmtuarit nga veprat penale, por nuk janë relevante për secilën vepër.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Spektori i Analizave Socio-Demografike është pjesë e Drejtorisë së Statistikave Sociale. Spektori ka një specialist i cili merret me statistikat juridike.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: http://www.instat.gov.al/media/371719/politika_e_revizionimit.pdf http://www.instat.gov.al/media/371533/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf

17.2. Praktika e rishikimit	Në rast ndryshimesh në pyetësoret që dërgohen në Eurostat për statistikat juridike, INSTAT bën rishikime në të dhënat.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Të dhënat bazohet në burime administrative.</p> <p>Ofruesit kryesorë të të dhënave janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Policisë së Shtetit, • Prokuroria e Përgjithshme, • Ministria e Drejtësisë, • Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. <p>Bazuar në këto burime, INSTAT mbledh, analizon dhe publikon të dhëna në lidhje me krimet dhe statistikat juridike. Të dhënat shprehen si numër dhe si tregues. Indikatorët e shprehura për 10 mijë banorë janë treguesit e kriminalitetit, shkalla e të burgosurve, norma e vrasjeve.</p>
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Të dhënat nga Drejtoria e Policisë së Shtetit janë tremujore dhe vjetore.</p> <p>Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë janë vjetore.</p>
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>INSTAT merr nga Drejtoria e Policisë një evidencë statistikore çdo tremujor të vitit. Kjo evidencë siguron të dhëna për veprat penale të kryera në Shqipëri në nivel kombëtar, për çdo vepër penale evidenca përmban të dhëna për rastet (rastet e evidentuara, rastet e zbuluara nga rastet e vjetra), të dhënat për personat e dëmtuar (të miturit, femra dhe të huaj) dhe autorët (personat e dyshuar) të ndara sipas masave të sigurisë.</p> <p>Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit midis 2 institucioneve, INSTAT siguron edhe të dhëna më të detajuara për kriminalitetin, të gjithë veprat penale sipas kodit penal.</p> <p>Nga Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT publikon të dhëna mbi personat e pandehur dhe procedimet penale sipas veprave penale. Në lidhje me të dhënat që kërkohen në pyetësorin e Eurostat, tabela të përgatitura dërgohen në formë shkresore pranë Prokurorisë.</p> <p>Një burim tjetër i të dhënave është dhe Ministria e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë publikon çdo vit një Vjetar Statistikor dhe INSTAT-i bazohet në këtë botim për të dhënë statistika mbi personat e dënuar, llojin e veprave penale, rastet e trajtuara sipas nivelit të gjykatave. Nga Gjykata e Lartë merret në formë shkresore një evidencë statistikore mbi rastet (penale, civile dhe administrative) të trajtuara prej tij nga secila gjykatë e qarkut. Kjo evidencë përmban statistika mbi çështjet, mënyrën e përfundimit të tyre dhe afatet e kohëzgjatjes së çështjeve.</p> <p>Të dhënat e lidhura me të burgosurit sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. INSTAT publikon të dhëna për të burgosurit të ndara sipas gjinisë, nivelit të arsimit, dy grupmoshave kryesore (të mitur</p>

	<p>nën 18 vjeç dhe të rritur mbi 18 vjeç) dhe sipas llojit të krimeve që janë dënuar. Informacioni merret nga formatet statistikore që burgjet kanë, i siguruar nga MoU midis 2 institucioneve. Në çdo IEVP ekziston një dokument i quajtur Komunikim ditor që plotësohet nga personeli i burgut, ky dokument përmban informacione për secilin person të burgosur. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mbledh këto të dhëna dhe siguron informacion për të burgosurit çdo tremujor.</p> <p>Këto burime janë shumë të rëndësishme për ecurinë e punës dhe për plotësimin e afateve të përcaktuara kohore, sepse INSTAT-i për statistikën e krimeve nuk ka ndërmarrë deri më sot ndonjë anketë.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Me metoda të verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim:</p> <p>Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, Korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha etj. Gjithashtu, INSTAT-i rishikon vlefshmërinë e të dhënave kur transmeton të dhënat e pyetësorit nëpërmjet sistemit elektronik të të dhënave dhe administratës së informacionit të Eurostatit (eDAMIS).</p>
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet
18.6. Rregullimi	Në statistikën juridike nuk bëhen rregullime në të dhënat.
19. Komente	
Aneks	